

Në pajtim me nenin 22 paragrafi 7 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 12/2019) dhe nenit 40 paragrafi 3 të Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, në seancën e 51-të, të mbajtur më datë 31 korrik 2021 morri,

VENDIM

Në bazë të dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit nuk ka elemente për veprimin e tij të mëtejshëm në lëndën me numër 09-4233 / 1 të datës 10.09.2019 sepse pohimet në denoncim se ///, profesoreshë e gjuhës angleze në /// është emëruar ///, dhe që personi në fjalë kryen më shumë funksione në universitet, pas së cilës Komisioni Shtetëror ndalon procedurat.

Lënda me numër 09-4233/1 të datës 10.09.2019 të mbyllet dhe të arkivohet .

Arsyetim

Lënda me numër 09-4233 / 1 nga data 10.09.2019 u formua në bazë të denoncimit anonim me pohime se personi ///, profesor i gjuhës angleze në /// u emërua këshilltar për bashkëpunim ndërkombëtar /// dhe personi /// është emëruar këshilltar - ///. Për personin /// thuhet se kryen disa funksione në universitet. Dhe ndërsa /// thuhet se është gruaja ///, kryetare e ///.

Për të përcaktuar pohimet në denoncim, Komisioni Shtetëror kërkoi informacion nga Universiteti /// në cilën procedurë /// i zgjedh këshilltarët e tij që e ndihmojnë në punën e tij, d.m.th. nëse ka procedurë të rregullt për këtë zgjedhje dhe informacione mbi funksionet e kryera nga personi ///.

Nga dokumentacioni i dorëzuar konstatohet se /// ka një funksion, këshilltar - rektor i mëparshëm. Personi i përmendur është ///, i zgjedhur nga ///. Ai u zgjedh këshilltar nga Bordi i /// me Vendim për zgjedhjen e këshilltarit të ///, /// i fundit i mëparshëm nr. 0202-654 / 7 të datës 17.09.2019, me propozim të Rektorit të Universitetit. Më tej në shkresë thuhet se rektori i mëparshëm e kryen funksionin në përputhje me nenin 151 paragrafi 4 alineja nga Statuti i Universitetit. Në shkresë thuhet se me kërkesë të këshilltarit - rektori i mëparshëm, ///, funksioni i tij përfundon me fillimin e vitit shkollor 01.10.2020. Që nga 01.10.2020, Rektori nuk ka asnjë këshilltar, me të cilën nuk konfirmohet pohimet në denoncim.

Deri te Komisioni Shtetëror me datë 01.10.2020 u arit Konkluzion me numër 28.09.2020, në të cilën theksohet /// e refuzon kërkesën e këshilltarit - /// për shkarkimin e tij, duke kërkuar sqarim nga Komisioni Shtetëror nëse ka konflikt interesi me personin në fjalë gjatë kryerjes së funksionit të këshilltarit - rektorit të mëparshëm.

Komisioni Shtetëror dorëzoi opinion për kërkësën e lartpërmendur nga /// se nuk ka gjendje konflikti interesash me personin /// lidhur me kryerjen e funksionit të këshilltarit - rektor i mëparshëm.

Duke pasur parasysh të theksuarën e mësipërme, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

KOMISIONI SHTEËOR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT
Kryetar,
Biljana Ivanovska

Pas përfundimit të seancës së KSHPK-së
Punoi: SM, bashkëpunëtor i larë
Miratoi: G.T, anëtar i KSHPK - së

